

INDEKSI



KUSHTIMIT NË NDËRTIM

Indëruar Përdorues.

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim është llogaritur deri tani duke marrë në konsideratë elementet e shpenzimeve për ndërtimin e një godine banimi me 5-6 kate. Tremujori i katër i vitit 1999 ka shërbyer si periudhë bazë. Çmimet e materialeve të ndërtimit dhe elementet e tjerë të kostos mblihdeshin nga firmat e ndërtimit.

Duke iu referuar situatës aktuale që paraqet sektori i ndërtimit përsa i përketë ndryshimit të strukturës së ndërtimit të banesave shumëkatëshe, si dhe elementeve të rinj të futur në procesin e ndërtimit lind nevoja e rinovimit të Indeksit, në mënyrë që ai të paraqesë më saktë realitetin.

Rinovimi i këtij indeksi u fokusua në:

- Ndryshimin e strukturës së elementëve të kostos në menyrë që kjo strukturë të jetë totalisht në përputhje me strukturën që përdor EUROSTAT.*
- Ndryshimin e burimit të marrjes së informacionit (çmimeve) të materialeve të ndërtimit nga firmat e ndërtimit në distributorët e shpërndarjes së materialeve duke rritur në këtë menyrë nivelin e përfaqësimit me çmimet për çdo tremujor.*
- Kombinimin e burimeve të ndryshme për sigurimin e informacionit (distributor të shpërndarjes së materialeve të ndërtimit, firmat e ndërtimit të dhëna nga aktivitete të tjera që realizon INSTAT)*

Duke filluar nga tremujori i parë 2011 INSTAT do të llogaritë indeksin e ri të Kushtimit në Ndërtim duke patur si periudhë bazë tremujorin e parë të vitit 2011 (Tr.I.2011=100). Ndërtimi i peshave të materialeve dhe shpenzimeve u bazua në preventivat e shpenzimeve të ndërmarrjeve të Ndërtimit për një ndërtesë 8-10 kate, ndërtesë kjo që u konsiderua si ndertëse tip për këtë periudhë.

Për llogaritjen e peshave të materialeve të ndërtimit kemi patur një bashkëpunim të ngushtë me inxhinier ndërtimi dhe specialist të fushës. Bashkëpunim kemi pasur dhe me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Bashkinë e Tiranës për sigurimin e informacionit të nevojshëm për zgjedhjen e shportës së materialeve dhe llogaritjen e peshave të tyre.

Të gjitha indeksat e mëparshme janë rillogaritur me bazën e re duke siguruar në këtë mënyrë vazhdueshmërinë e serisë kohore të indekseve.

INDEKSI I KUSHTIMIT NË NDËRTIM I - 2012

Në tremujorin e parë 2012, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim arriti 100.3 përqind (**Tremujori i I 2011=100**), duke shënuar një ulje prej 0.2 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011 Indeksi i Kushtimit në ndërtim ka shënuar një rritje me 0.3 përqind. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0.5 përqind.

Indeksi i çmimeve të grupit “Shpenzime materiale” është ulur me 1.7 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm. Brenda këtij grupi indeksi i çmimeve të nëngrupit

“Materiale Ndërtimi” ka shënuar një ulje prej 1.8 përqind. Gjithashtu ulje kanë shënuar indeksi i çmimeve të “Materialeve elektrike dhe komunikimi” dhe indeksi i çmimeve “Materiale hidro-sanitare” respektivisht me 1.9 përqind dhe 0.9 përqind.

Indekset e grupeve “Shpenzime transporti” dhe “Shpenzime makinerie” u rritën respektivisht me 0.3 përqind dhe 0.8 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Gjithashtu një rritje prej 2.4 përqind pati dhe indeksi i grupit “Kosto të tjera”.

Krahasuar me tremujorin e mëparshëm një zbritje me 0.7 përqind ka pasur grupi “Shpenzime page”. Në këtë tremujor, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për grupet e tjera nuk ka ndryshuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

PESHAT SIPAS GRUPEVE KRYESORE TË SHPENZIMEVE


GRUPET	PESHAT NË%
GJITHSEJ	100
1. SHPENZIME MATERIALE	55.2
a. Materiale ndërtimi	42.3
b. Materiale elektrike	6.7
c. Materiale hidro - sanitare	6.2
2. SHPENZIME PËR PAGA	24.6
3. SHPENZIME MAKINERIE	8.3
4. SHPENZIME TRANSPORTI	5.3
5. SHPENZIME PER ENERGJI	2.1
6. KOSTO TE TJERA	4.5

INDEKSI I KUSHTIMIT NË NDËRTIM

Tremujori I /2011 = 100

Emërtimi	I - 08	II - 08	III - 08	IV - 08	I - 09	II - 09	III - 09	IV - 09	I - 10	II - 10	III - 10	IV - 10	I - 11	II - 11	III - 11	IV - 11	I - 12	I - 12/ I - 11
TOTALI (1+2+3+4+5+6)	98.5	99.3	99.7	99.8	99.4	99.3	99.3	99.4	99.5	99.6	99.7	99.8	100	99.8	100.2	100.5	100.3	0.3
1. SHPENZIME MATERIALE (a+b+c)	98.5	99.8	100.5	100.3	99.2	98.9	98.7	98.8	99.1	99.2	99.5	99.6	100	100.3	100.5	101.6	99.8	-0.2
a. Materiale ndërtimi	98.7	100.2	100.9	100.6	99.3	99.0	98.7	98.8	99.1	99.2	99.5	99.6	100	100.4	100.4	101.7	99.9	-0.1
b. Materiale elektrike dhe komunikimi	82.8	84.7	84.7	87.9	91.8	94.4	94.8	95.3	95.7	97.8	99.2	99.5	100	99.7	101.0	101.2	99.3	-0.7
c. Materiale hidro - sanitare	99.1	98.4	98.4	98.6	99.0	99.2	99.5	99.6	99.6	99.6	99.6	99.7	100	100.0	100.3	100.9	99.9	-0.1
2. SHPENZIME PËR PAGA	96.0	96.3	96.4	97.9	99.5	99.6	99.8	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100	100.3	102.6	101.5	100.8	0.8
3. SHPENZIME MAKINERIE	100.0	100.0	100.0	100.3	99.8	99.3	99.6	99.6	99.8	99.8	99.8	100.0	100	100.0	99.9	100.1	100.9	0.9
4. SHPENZIME TRANSPORTI	95.6	95.6	95.6	95.3	98.0	98.2	98.2	98.2	98.8	99.6	99.8	99.9	100	98.8	99.4	100.2	100.5	0.5
5. SHPENZIME PER ENERGJI													100	100.0	100.0	100.0	100.0	0.0
6. KOSTO TE TJERA													100	99.0	97.6	98.7	101.1	1.1


INDEKSI I KUSHTIMIT NË NDËRTIM



NDRYSHIMET TREMUJORE TË INDEKSIT TË KUSHTIMIT NË NDËRTIM

Emërtimi	I - 08	II - 08	III - 08	IV - 08	I - 09	II - 09	III - 09	IV - 09	I - 10	II - 10	III-10	IV-10	I-11	II-11	III-11	IV-11	I-12	
TOTALI (1+2+3+4+5+6)	0.1	0.8	0.4	0.1	-0.4	-0.1	-0.1	0.1	0.2	0.2	0.2	0.1	0.2	-0.2	0.4	0.3	-0.2	
1. SHPENZIME MATERIALE (a+b+c)	-0.8	1.4	0.7	-0.2	-1.1	-0.3	-0.2	0.1	0.3	0.4	0.3	0.1	0	0.3	0.2	1.1	-1.7	
a. Materiale ndërtimi	-0.9	1.5	0.7	-0.3	-1.3	-0.3	-0.2	0.1	0.3	0.4	0.3	0.1	0	0.4	0.0	1.3	-1.8	
b. Materiale elektrike dhe komunikimi	1.5	2.3	0.0	3.8	4.6	2.9	0.4	0.5	0.5	2.7	1.4	0.3	1	-0.3	1.4	0.1	-1.9	
c. Materiale hidro - sanitare	0.8	-0.8	0.1	0.2	0.4	0.1	0.3	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0	0.0	0.3	0.5	-0.9	
2. SHPENZIME PËR PAGA	4.6	0.3	0.1	1.6	1.7	0.0	0.2	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0	0.3	2.3	-1.1	-0.7	
3. SHPENZIME MAKINERIE	2.4	0.0	0.0	-0.3	2.9	0.2	0.0	0.0	0.6	1.4	0.2	0.1	0	0.0	-0.1	0.2	0.8	
4. SHPENZIME TRANSPORTI	1.2	0.0	0.0	0.3	-0.5	-0.4	0.3	0.0	0.2	0.2	0.0	0.2	0	-1.2	0.6	0.8	0.3	
5. SHPENZIME PER ENERGJI														0.0	0.0	0.0	0.0	
6. KOSTO TETJERA															-1.0	-1.4	1.1	2.4

NDRYSHIMET TREMUJORE TË INDEKSIT TË KUSHTIMIT NË NDËRTIM



SHËNIME METODOLOGJIKE

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (IKN) mat ecurinë e çmimeve të: materialeve të ndërtimit, fuqisë punëtore dhe shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate).

IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit. Përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qëndrore, Organizma të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj.

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (IKN) duke filluar nga tremujori i parë 2011 do të llogaritet me shportën e re të materialeve dhe shpenzimeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit.

Tremujori i parë i vitit 2011 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 73 zëra nga të cilat 68 janë materiale ndërtimi.

Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 96 distributore dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa të dhënat për shpenzimet për paga, makineritë dhe transportin merren nga 50 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqendruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që realizojnë ndërmarrjet gjatë një periudhe një vjeçare.

Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksën e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Materiale ndërtimi
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Për llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0t}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left(\frac{P_t^i}{P_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Ku:

I_{0t} = Indeksi l periudhës t krahasuar me periudhën bazë 0

P_t^i = Çmimi për njësi i artikullit i në një periudhën t (koha korente)

P_0^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën 0 (periudha bazë)

w_0^i = Pesha e artikullit i në periudhën bazë

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis tremujorit korrent me të njëjtin tremujore të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo tremujore.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me tremujorin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale dhe efekte të tjera.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Blv. "Zhan D'Ark" Nr.3, Tiranë, Tel: + 355 4 2222411 / 2233356, Fax: + 355 4 2228300,
email: botim_difuzion@instat.gov.al web: www.instat.gov.al